

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA E KOSOVO  
KOMUNA E VUSHTRISË - OPŠTINA VUČITRAN  
Nr. / B.: 17535/25  
Nr. / Fq. / Nr. st. - 2 -  
Data / Datumi: 23.04.25  
VUSHTRRI - VUČITRAN



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
**Komuna e Vushtrrisë**  
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtrri



### Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 70/25 23/04/2025

### PROCESVERBAL

**nga mbledhja e Komitetit për Komunitete, mbajtur më 26 mars 2025 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 14:15.**

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin: Zdravko Zdravkoviç (kryesues), Kushtrim Hyseni, Zojë Hajrizi, Behar Duraku, Gresa Muli, Zana Krasniç Saraçi, Berat Maloku, Aziz Emiri dhe Adem Hoti, anëtarë të komitetit.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: përfaqësues të KFOR-it slloven, OSBE-së, UNMIK-ut, Aktere Dërvari - përkthyes, si dhe Bujar Klinaku nga sekretaria e kuvendit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Zdravko Zdravkoviç, kryesues i Komitetit për Komunitete, i cili konstatoi se ekziston shumica për punë.

Ai tha se më datën 18 mars, përmes sekretarisë iu kemi dërguar ftesë kryetarit të komunës dhe drejtorit të bujqësisë, por asnjëri nuk janë të pranishëm. Prandaj, po vendosim bashkërisht se çka do të bëjmë me pikën 2 “Diskutim i hapur rreth gjendjes në bujqësi”.

**Berat Maloku, anëtar i komitetit-** ky problem i mospjesëmarrjes në mbledhje është kaheër, dmth. që 4 vjet. Është viti i fundit dhe vit zgjedhor, nuk i kushtojnë rëndësi Komitetit për Komunitete, por punëve të veta. Ndjej keqardhje që drejtori i bujqësisë i takon komunitetit tim dhe nuk ju përfillet kërkesave të komitetit.

**Zdravko Zdravkoviç, kryesues i komitetit** – a ta diskutojmë temën e bujqësisë apo ta shtojmë për mbledhjen e ardhshme?

**Berat Maloku, anëtar i komitetit-** konsideroj se është e kotë t’ju dërgojmë ftesa drejtorëve, për shkak se është vit zgjedhor. Tash e tutje është mirë t’ju japim rëndësi temave të ndryshme. Moti këtë javë është me shi dhe mund të ketë vërshime. Andaj, ato vende që janë të rrezikuara, secili me komunitetin e vet të përgatitet për t’i evituar vërshimet. Andaj, të kalojmë në pikën e tretë.

**Adem Hoti, anëtar i komitetit-** tha se a do të ishte më mirë që të shkojmë 3-4 anëtarë të komitetit te kryetari dhe të bisedojmë.

***Komiteti për Komunitete njëzëri vendosi që ta heq nga rendi i ditës pikën 2 "Diskutim i hapur rreth gjendjes në bujqësi".***

***Komiteti për Komunitete njëzëri aprovoi këtë:***

## **R E N D I T E**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

***Komiteti për Komunitete njëzëri aprovoi procesverbalin nga mbledhja e kaluar.***

2. Të ndryshme.

**Berat Maloku, anëtar i komitetit-** lidhur me atë që e tha Ademi për me shkuar te kryetari me bisedu. Mendoj se ftesë më të madhe se zyrtarisht nuk ka. Ju ka shkuar ftesa përmes postës elektronike dhe janë kanë të njoftuar për mbledhjen. Andaj, t'i kryejmë ne punët tona dhe t'i ndihmojmë komunitetit aq sa kemi mundësi. E shpresojmë që nuk do të ketë vërshime. Bujqit ta kenë shëndetin, e të kenë suksese në punën e tyre. Një drejtor që e ka marrë në qafë bujqësinë në komunën tonë është drejtori i bujqësisë. Kurse, një njeri që e ka ngjallë bujqësinë e Kosovës është ministri i bujqësisë. Shpresojmë që kryetari i ardhshëm i komunës ta ketë prioritet bujqësinë dhe ndihmat për skamnorët. Po ashtu, shpresojmë që Komitetit për Komunitete në mandatin e ardhshëm, kryetari do ti japë vlera dhe do të na shkojë më shumë fjala, pa marrë parasysh se kush do të jetë anëtarë.

**Zdravko Zdravković, kryesues i komitetit** – më vjen keq që drejtori i bujqësisë nuk është i pranishëm, sepse kam pasur t'ia parashtrijë disa pyetje. A do të ketë subvencion për disa makina në bujqësi? A do të ketë subvencione për serra?

Viteve të kaluara ka qenë shqetësim digjitalizimi i parcelave për bujqit. Pra, është bërë një digjitalizim jo i duhur i parcelave, ku nënvizohet keq dhe dikush tjetër e shfrytëzon aplikimin. Qytetarët më pyesin se pse nuk po bëhet digjitalizimi në bazë të numrit të parcelës. Këto janë disa pyetje që kam dashur t'ia parashtrijë drejtorit të bujqësisë. Pajtohem me Beratin lidhur me rreziqet nga vërshimet. Andaj, kisha kërkuar që secili anëtarë i komitetit të ketë kujdes për komunitetin e tij.

**Mbledhja përfundoi në ora 14:35.**

**Bujar Klinaku**

**Procesmbajtës**

